

Ferma 3 Fshatin Vezhdanisht me pronar Fuat Breshani

Parcela pilot u ngrit në fshatin Vezhdanisht në një terren malor. Në këtë parcelë u mbollën 200 fidana ulli të prodhuara me nebulizim të kultivarit “Kalinjot”. Fidanët ju dhanë pronarit nga Q T T B., si dhe asistencë teknike nga specialistët e këtij institucioni.

Bimët e ullirit kanë arritur gjatësi 180 -200 cm , me trashësi në treungun e trupit 25-40 mm diametër nga 4-6 mm që ishin në momentin e mbjelljes para një viti. Nga verifikimi i bimëve në parcelë të kryera në muajin shtator rezultoi që të mos kemi asnjë bimë mangut nga sasia prej 200 bimësh që u mbollën në vitin 2012.

Foto1.Ullishtja në fund të vitit të parë pas mbjelljes



Foto2,3,4.Ullishtja në fund të vitit të dytë pas mbjelljes



Dhjetor .2013

Konkluzione.

1-Perdorimi i fidanave të shtuar me copa vegetative për ngritjen e ullishtave është një mënyrë e re e cila po zbatohet gjerësisht sot në botë.

2-Fidani per mbjellje duhet te te kete nje lartesi jo me te madhe se 50-70 cm pasi kur ai mbillet ne vendin e perhereshem ambientohet shume me mire me kushtet e reja te tokes dhe klimes ,perfiton shume nga sherbimet agroteknike duke siguruar nje rritje te mire vegjetative qysh vitin e pare.

3-Fidanat e kultivarit “Kalinjot” te prodhuar me copa vegjetative me nebulizm kane nje kosto te ulet dhe nje cmim shitje qe perballohet lehte nga fermeret (200 leke) ne nje kohe qe fidanat e shartuar por edhe ata te sjelle nga jashte kushtojne nga 300leke deri ne 550 leke.

4-Fidanat e ullirit te shtuar me copa vegjetative me nebulizim te kultivarit “Kalinjot” paraqesin qendrushmeri te larte ndaj tuberkulozit te ullirit (P. Sevastanoi) , semundje kjo e cila shkakton demtim te ndjeshem gjate rritjes se bimes por edhe gjate periudhes prodhuese.

5-Eshte shume e rendesishme qe ulliri te mbillet ne terrene te pershtateshme, te pasura, te kulluara dhe mundesisht te lejojne punimet e mekanizuara me synim uljen e kostos.

6- Monitorimi i vazhdueshem i bimeve per prekje nga parazite te ndryshem dhe marrjen e masave per kontrollin e tyre ne kohe e me cilesi , garanton rritjen normale te ullirit.